



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 7633 Prot.

Lezhë, më 20 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 79 Datë 19 . 04 . 2021

Për

Miratimin e kërkesës së Z. Pashk Prengë Rama për të përfituar nga grantet e rindërtimit nëpërmjet programit të rindërtimit nga banesat e dhuruara

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.115, datë 26.08.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë", shkresës nr.555 Prot., datë 24.02.2021 të Entit Kombëtar të Banesave, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Miratimin e kërkesës së Z.Pashk Prengë Rama, për të përfituar nga grantet e rindërtimit nëpërmjet banesave të dhuruara. Bashkëlidhur dosja përkatëse e subjektit përfitues për një nga banesat e dhuruara sipas shkresës nr.555 Prot., datë 24.02.2021 të Entit Kombëtar të Banesave.
2. Miratimi i dhënë nga Këshilli i Bashkisë t'i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave për ndjekjen e procedurave ligjore përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

